REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË RADIOTELEVIZIONIT PUBLIK SHQIPTAR (RTSH)
PËR VITIN 2015

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke besuar se RTSH-ja duhet të zhvillohet në drejtim të përmbushjes së misionit të vet primar për garantimin e shprehjes së interesave të publikut dhe fitimin e besimit të tij te ky organ;
- Duke theksuar se RTSH-ja ka një rol kyç në procesin e dixhitalizimit, jo vetëm në aspekt të zhvillimit të tij teknologjik dhe konkurrencën mediatike, por dhe të mundësisë së zhvillimit të mediave të tjera që do të mbështeten në rrjetet e tij numerike;
- Duke vlerësuar se organet drejtuese të RTSH-së kanë përpara një sërë sfidash në reformimin tërësor shumëplanësh të këtij organi, për të zbatuar detyrimet e tij institucionale, sipas standardeve dhe detyrimeve ndërkombëtare;
- Kuvendi i Shqipërisë, në rolin e tij ligjbërës dhe kontrollues të zbatimit të ligjit, shpreh mbështetjen e tij në proceset aktuale që po zhvillon RTSH-ja në përmbushjen e procesit të dixhitalizimit, si dhe transformimit tërësor programor dhe organizativ, me qëllim që RTSH-ja të garantojë pavarësinë editoriale, përmes forcimit të transparencës, llogaridhënies së RTSH-së para taksapaguesve të tij dhe, për rrjedhojë, edhe rritjen e audiencës publike.

Kuvendi i Shqipërisë vëren se gjatë vitit 2015:

- Veprimtaria e RTSH-së gjatë është drejtuar nga Këshilli Drejtues vetëm në gjysmën e dytë të vitit 2015, pas konstituimit të plotë të tij në maj 2015.
- RTSH-së i ka munguar drejtuesi menaxherial dhe përgjegjësi editorial, pasi Këshilli nuk mundi të zgjedhë dot Drejtorin e ri të Përgjithshëm të tij, për shkak të mosarritjes së votave të nevojshme të kërkuara në ligj.
- Organet e tjera që përcakton ligji ende nuk janë formësuar për t'iu përgjigjur detyrimeve dhe përgjegjësive përkatëse.
- Si pasojë e mangësisë, si dhe mungesës së organeve drejtuese, aktet nënligjore më të rëndësishme, si statuti dhe rregullorja e RTSH-së, nuk janë miratuar edhe gjatë vitit 2015.
- RTSH-ja ende nuk ka miratuar kontratën e shërbimit të transmetimit publik, ku përcaktohen parimet që zbaton dhe veprimtaritë që merr përsipër për përmbushjen e qëllimeve të veta, duke dalë jashtë afateve ligjore për nënshkrimin e saj nga AMA.

Pavarësisht problemeve të konstatuara në këtë raport, Kuvendi vlerëson disa arritje gjatë veprimtarisë së vitit 2015, sa i takon:

- Rritjes së të ardhurave, si pasojë e arkëtimit të tarifës së aparatit marrës TV dhe përqendrimin e këtyre të ardhurave në investime për rinovimin e teknologjisë në sistemin e transmetimit, por dhe në shtimin sasior dhe cilësor të programeve;
- Nisjes së zbatimit zyrtarisht të projektit të ndërtimit të dy rrjeteve numerike të transmetimit të RTSH-së, me fillimin e fazës së parë të ndërtimit të rrjetit;
- Pasurimit të strukturës programore me disa rubrika, sidomos në fushat e ekonomisë, të artit dhe të kulturës;
- Ka vijuar realizimin dhe transmetimin e eventeve më të rëndësishme artistike, që janë zhvilluar në Shqipëri;
- RTSH-ja ka marrë pjesë rregullisht dhe ka realizuar të gjitha projektet me EBU-në;
- Është përpjekur të rrisë audiencën, duke eksperimentuar *on-line streaming* gjatë eventeve kulturore sportive ndërkombëtare;
- Ka pasur në fokus media *online* për pasqyrimin në *website* të të gjitha prodhimeve të Radio-televizionit Shqiptar, tekst, audio dhe video.

Për vitin 2016, Kuvendi i Shqipërisë kërkon nga Këshilli i ri Drejtues të përmbushë këto detyrime:

1. Emërimin sa më parë të drejtorit të përgjithshëm, të Bordit të Administrimit dhe të Këshillit për Shikuesit dhe Dëgjuesit;
2. Miratimin e Statutit të RTSH-së dhe rregullores së brendshme të organizimit;
3. Miratimin e kontratës së shërbimit të transmetimit publik dhe nënshkrimin e saj nga AMA, duke siguruar mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj kontrate, si dhe koordinim të ngushtë me AMA-n gjatë procesit për ndërtimin e rrjeteve numerike të RTSH-së;

4. Mbylljen e suksesshme të përfundimit të fazës së parë të ndërtimit të rrjetit numerik, sipas planifikimit në qershor–korrik 2016 dhe mbulimin me sinjal të paktën të 85 për qind të popullsisë;

5. Organizimin e një fushate të gjerë për informimin e publikut për procesin e dixhitalizimit;

6. Reformimin shumëdimensional të RTSH-së, përmes një platforme gjithëpërfshirëse, strukturore, organizative, programore e teknike;

7. RTSH-ja të sigurojnë që veprimtaria e saj të realizohet në përputhje me kërkesat e ligjit dhe statutit të vet, me qëllim që t'u përgjigjet interesave të publikut të gjerë, duke mbështetur të drejtat e shprehjes dhe të informimit, duke rritur besimin dhe audiencën e publikut të gjerë në të;

8. RTSH-ja të synojë konkurrencën mediatike dhe shtimin e të ardhurave nga mënyra e organizimit, prodhimit të programeve dhe shitjen e tyre, veprimtaritë e tjera nga shfaqjet publike apo marketing në nivele të duhura;

9. RTSH-ja të sigurojë në praktikë pavarësinë e plotë financiare, administrative dhe editoriale, në përputhje me pavarësinë e përcaktuar në ligj.

Miratuar në datën 21.4.2016

KRYETARI
Ilir Meta